




Planuar / Dorezuar Priljeno/Prodato Received/Delivery	09.03.2022	2	viti god year
Organ./Njesia Organ./Jedinica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojc Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKINMSHCK	1265/2022		1/4



## Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.51/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave në përbërje nga: Eshref Shabani-kryetar, Malësore Gashi Bajraktari dhe Jeton Koca-anëtarë me Çlirim Zeka-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.51/2022 të datës 24.01.2022 të parashtruar nga ankuesja

Themelore Komuna e Prishtinës, kundër organit të punësimi/Agjencia Për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale të Kosovës, në çështjen juridike "kompensim material", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 09.03.2022, mori këtë:

### V E N D I M

Refuzohet si e pa bazuar ankesa me numër A.nr.51/2022 e datës 24.01.2022 e parashtruar nga ankuesja

### A r s y e t i m

Sipas shkresave të lëndës ankuesja me datë 24.01.2022, ka parashtruar ankesë me numër të protokollit Nr.prot.296/2022, kundër përgjigjes të datës 23.12.2021 të Drejtorit të Departamentit për Financa dhe Shërbime të Përgjithshme të Agjencisë për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale të Kosovës, ndërsa me datë 01.02.2022 ka bërë plotësim e ankesës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 04.02.2022 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë të

ankueses në Agjencinë për Menaxhimin e Komplekseve Memorialë të Kosovës. Me datën 11.02.2022 ,Këshilli ka pranuar përgjigje në ankesë nga Agjencia për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale të Kosovës lidhur me provat e bashkangjitura të lëndës.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka administruar këto prova: Ankesën me Nr.prot: 296/2022 të datës 24.01.2022 e parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Plotësimin e ankesës së ankueses me Nr.prot: 438/2022 të datës 01.02.2022; Akt Emërimi i ankuesit i datës 30.09.2019; Akt Emërimi i ankueses i datës 07.06.2019; Formulari i të dhënave për listën e pagave të datës 11.06.2020; Konfirmim i datës 08.06.2020 i disponueshmërisë së mjeteve buxhetore për shtesat në pagë nga AMKMK; Kërkesë për aprovimin e shtesave në pagë të datës 08.06.2020; Kërkesë për aprovimin e shtesave në pagë të datës 09.06.2020; Vendim për aprovimin e kërkesës për shtesën në pagë i datës 09.06.2020; Kërkesën për pagesën e shtesës në pagë nga ankuesja të datës 10.12.2021; Përgjigjen lidhur me kërkesën për pagesën e shtesës në pagë të datës 23.12.2021; Kërkesë për përgjigje në ankesë të datës 04.02.2022; Përgjigje në ankesë të datës 11.02.2022; Përshkrimin e detyrave të punës së ankueses; Rregullore Nr.01/2019 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës të Agjencisë për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale të Kosovës së bashku me organogramin e kësaj agjencie; Vendimin me numër Nr.02/39 të datës 08.10.2008 të Republikës së Qeverisë së Kosovës; Vendimin me numër Nr.07/29 të datës 31.07.2008 të Republikës së Qeverisë së Kosovës.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës, ka konstatuar se ankesa e ankueses [redacted] është e pabazuar, sepse:

Bazuar në shkresat e lëndës, Kolegji ka gjetur se ankuesja është e punësuar sipas Akt Emërimit të datës 07.06.2019 në pozitën "Zyrtare për Mbështetje Operative", në Agjencinë për Menaxhimin e Komplekseve Memorialë të Kosovës. Sipas shkresave të lëndës ankuesja ka bërë kërkesë me datë 08.06.2020 dhe 09.06.2020, lidhur me aprovimin e shtesës në pagë në vlerën prej 250 euro nga ana e Agjencisë për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale të Kosovës, duke u bazuar në vendimin me numër Nr.02/39 të datës 08.10.2008 të Qeverisë së Republikës së Kosovës. Me datë 09.06.2020, Drejtori i Agjencisë për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale të Kosovës, ka nxjerrë vendim për aprovimin e kërkesës për shtesë në pagë për ankuesen në vlerën prej 250 euro bazuar në vendimin me numër Nr.02/39 të datës 08.10.2008 të Qeverisë së Republikës së Kosovës.

E pakënaqur me mos zbatimin e vendimit të datës 09.06.2020, të lëshuar nga Drejtori i Agjencisë për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale të Kosovës lidhur me aprovimin e shtesës në pagë, me datë 10.12.2021 ka parashtruar prapë kërkesë për pagesën e shtesës në pagë në vlerën prej 250 euro. Me datën 23.12.2021 Drejtori i Departamentit për Financa dhe Shërbime të Përgjithshme në Agjencinë për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale të Kosovës, i është përgjigjur kërkesës së ankueses lidhur me pagesën e shtesës në pagë bazuar në atë se ky institucion ka ndërmarrë të gjitha veprimet lejuara duke përfshirë këtu edhe nxjerrjen e vendimit të datës 09.06.2020 sipas të cilit Drejtori i Agjencisë për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale të Kosovës ka aprovuar këtë shtesë.

Ankuesja e pakënaqur me përgjigjen e Agjencisë për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale të Kosovës lidhur me kërkesën për pagën shtesë, brenda afatit ligjor respektivisht me datën 24.01.2022, ka ushtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimet ankimore se ky vendim përmban shkelje thelbësore të dispozitave ligjore, shkelje procedurale dhe vlerësim të gabuar, jo real dhe jo të plotë me gjendjen faktike.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosje e ankesave, gjatë shqyrtimit të ligjshmërisë së pretendimeve ankimore të ankuesit, ka analizuar Vendimin Nr.02/39 të datës 08.10.2008 të Qeverisë së Republikës së Kosovës, përmes të cilit është aprovuar lista e pozitive dhe shtesave në pagë për kategori të veçanta të profesioneve deficitare në fushën e teknologjisë informativë dhe inxhinieringut, dhe Vendimin Nr.07/29 të datës 31.07.2008 të Qeverisë së Republikës së Kosovës, me të cilin është përcaktuar procedura për parashtrimin dhe trajtimin e kërkesave dhe mënyra e realizimit të shtesave për kategoritë e veçanta të profesioneve deficitare, dhe rrjedhimisht është konstatuar se aprovimi i shtesave në pagë për pozita deficitare është bërë me qëllim të ruajtjes së kategorive të veçanta deficitare të punonjësve, stimulimit të konkurrimit për profesione të veçanta deficitare dhe zbatimit të parimit të pagesës së njëjtë për punë të njëjtë në të gjitha organizatat buxhetore. Po ashtu, me këtë vendim është përcaktuar se paga bazë së bashku me shtesat mbi pagë nuk mund të tejkalojnë pagën e zyrtarëve të lartë të emëruar nga KELP-i, si dhe është obliguar Ministria përgjegjëse për Administratë Publike dhe Ministria e Financave për shqyrtimin e listës dhe standardëve kualifikuese dhe shumës stimuluese për postet e caktuara, së paku një herë në gjashtë muaj.

Kuvendi i Republikës së Kosovës, me datë 13.05.2010 ka aprovuar Ligjin Nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil, përmes të cilit është bërë përcaktimi i sistemit dhe strukturës së pagave, shtesave dhe kompensimeve të tjera për nëpunësit civilë, ndërsa me dispozitat e nenit 14 të këtij ligji është përcaktuar se: *1. Shtesat mbi pagën bazë janë: 1.1. shtesa për punë me ndërrime dhe jashtë orarit të punës; 1.2. shtesa për kushte specifike pune; dhe 1.3. shtesa për kushtet e tregut.* Përkritazi me këtë, duke u bazuar në dispozitat e nenit 27 të Ligjit Nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil, Qeveria e Republikës së Kosovës, me datë 24.12.2012 ka aprovuar Rregulloren Nr.33/2012 për Shtesat në Pagë dhe Kompensime të Tjera të Nëpunësve Civil, përmes të cilës ka përcaktuar kushtet dhe procedurat për shtesat dhe kompensime të tjera mbi pagën bazë të nëpunësve civilë. Me hyrjen në fuqi të kësaj rregullore janë shfuqizuar të gjitha aktet nënligjore të cilat kanë rregulluar shtesat dhe kompensimet tjera të nëpunësve civil, dhe rrjedhimisht edhe Vendimi Nr.02/29 i datës 31.07.2008 dhe Vendimi Nr.02/39 i datës 08.10.2008 i Qeverisë së Republikës së Kosovës, konstatim ky i dhënë edhe në Raportin Vjetor të Vitit 2017 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kështu që duke u bazuar në këtë konstatim, Kolegji vlerëson se pretendimi ankimor i ankuesit për realizimin e shtesës në pagë sipas Vendimit Nr.02/39 të datës 08.10.2008 të Qeverisë së Republikës së Kosovës, është i pa bazuar.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.33/2012 për Shtesat në Pagë dhe Kompensime të Tjera të Nëpunësve Civil, përkatësisht nenin 8 të kësaj rregullore, ka arritur të konstatojë se Ministria përgjegjëse për administratë publike, në bashkëpunim me ministrinë përgjegjëse për financa, mund të kërkojë nga Qeveria që të miratojë një shtesë për kushtet e tregut për pozitat ose llojet e pozitive për të cilat niveli i pagës për personelin

e ngjashëm nga organizatat dhe punëdhënësit e tjerë jashtë Shërbimit Civil është së paku 40% më i lartë sesa niveli i pagës që ofrohet nga Shërbimi Civil, e kjo shkakton vështirësi të konsiderueshme në rekrutimin dhe mbajtjen e personelit të kualifikuar për ato pozita ose lloje të pozitave në administratë publike, ndërsa institucioni për realizimin e shtesës për kushtet të veçanta të tregut duhet t'i ofrojë Ministrisë përgjegjëse për administratë publike kërkesën lidhur me arsyeshmërinë e realizimit të shtesës dhe një analizë që dëshmon vështirësitë të cilat janë hasur nga institucioni gjatë rekrutimit dhe mbajtjes së personit të kualifikuar, listën e pozitave përkatëse dhe koston vjetore të vlerësimit financiar. Shtesa mbi pagën bazë për kushte të veçanta të tregut nuk mund të tejkalojë më shumë se 50% të pagës bazë.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

## KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda me numër A.nr.51/2022

Çlirim Zeka



Procesmbajtës



### Vendimi i dorëzohet:

- Ankueses
- Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale të Kosovës;
- Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore të Agjencisë për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale të Kosovës dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

